



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:050839
Datë: 13.05.2024
Numri i dokumentit: 05697437

Ac.nr.5076/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësve R.M., Xh.M. dhe A.M., të gjithë nga fshati ..., Komuna e Rahovecit, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson S.M., avokat në Prizren, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.O., avokat në Rahovec, me objekt të kontestit kompensimin i ushqimit gjatë punës, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.162/2021, të datës 08.03.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 30.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZHET pjesërisht e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit–Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.162/2021, i datës 08.03.2022, në pikën I dhe II të dispozitivit, **VËRTETOHET**.

II. APROVOHET pjesërisht e themeltë ankesa e të paditurës Komuna e Rahovecit–Drejtoria Komunale e Arsimit, **NDRYSHOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, C.nr.162/2021, i datës 08.03.2022, në pikën III të dispozitivit në pjesën ku është detyruar e paditura që paditësve t’ia paguaj shpenzimet e procedurës, ashtu që gjykohet si në vijim: **DETYROHET** e paditura Komuna e Rahovecit-Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësve R.M., Xh.M. dhe A.M., të gjithë nga fshati ..., Komuna e Rahovecit, në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguaj shumën prej 499.40 euro, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës për shpenzime mbi këtë shumë refuzohet e pabazuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Rahovec, me aktgjykimin e atakuar C.nr.162/2021, të datës 08.03.2022, ka vendosur si në vijim: “APROVOHET padia dhe kërkesëpadia e paditësve R.M., Xh.M. dhe A.M. dhe DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit-Drejtoria e Arsimit, që paditësve në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e punës (shujtës ditore) paditësve tu paguaj si vijon: -Paditësit të parë R.M., në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë punës për 273 ditë nga data 21.11.2019 e deri me 18.04.2021, në vlere prej dy (2) € për një ditë pune, shumën prej 546.00 €. -Paditësit të dytë Xh.M., në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë punës për 273 ditë nga data 21.11.2019 e deri me 18.04.2021, në vlere prej dy (2) € për një ditë pune, shumën prej 546.00 €. -Paditësit të tretë A.M., në emër të shpenzimeve për ushqim gjatë punës për 273 ditë nga data 21.11.2019 e deri me 18.04.2021, në vlere prej dy (2) € për një ditë pune, shumën prej 546.00 €, apo shumën e përgjithshme për të gjithë paditësit 1638.00 €, të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, duke e llogaritur prej ditës së paraqitjes së padisë nga data (17.03.2021), e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm SI ME BAZË. DETYROHET e paditura që në po të njëjtin afat, paditësve t’ua paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej 707.40 € me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm”.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura nëpërmjet të autorizuarit të saj, në afat ligjor ka paraqitur ankesë, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit të Kosovës, ta aprovoj ankesën e paraqitur, ta ndryshoj aktgjykimin e goditur duke e refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësve ose ta aprovoj ankesën dhe të prish në tërësi aktgjykimin e atakuar dhe çështjen ta kthej në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditësve duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet si e pathemeltë dhe aktgjykimi C.nr.162/2021 datë 08.03.2022, të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pjesërisht e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, kundër të paditurës, kanë parashtruar padi me datën 17.03.2021, për kompensimin e ushqimit gjatë punës (shujtave), të precizuar me parashtrësën e datës 03.04.2022, duke kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia ashtu që të detyrohet e paditura që paditësve t’ua paguaj shumat si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar. E paditura, me anë të përgjigjes në padi, e ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësve, duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësve, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave pas shqyrtimit kryesor të çështjes ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.162/21, të datës 08.03.2022, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar së me shikimin në kontratën e punës të datës 01.05.2015, vërtetohet se paditësi A.M., është i sistemuar në punët dhe detyrat e punës, Punëtor ndihmës në SHFMU “4 Dëshmoret”, në fshatin ..., komuna e Rahovecit, ndërsa në bazë të vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë për paditësin A.M., të lëshuar nga drejtori i shkollës me datën 18.04.2021, është vërtetuar se i njëjti nga data 21.11.2019 e deri me datën 18.04.2021, ka gjithsej 273 ditë pune. Me shikimin në kontratën e punës nr. i protokollit 01/310, të datës 01.09.2015, vërtetohet se paditësi R.M., është i sistemuar në punët dhe detyrat e punës, Punëtor teknik, në institucionin arsimor SHFMU “4 Dëshmoret” në fshatin ..., Komuna e Rahovecit, ndërsa në bazë të vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë për paditësin R.M., të lëshuar nga drejtori i shkollës me datën 18.04.2021, është vërtetuar se i njëjti nga data 21.11.2019 e deri me datën 18.04.2021, ka gjithsej 273 ditë pune. Me shikimin në kontratën e punës nr.i protokollit 01/316, të datës 01.09.2015, vërtetohet se paditësi Xh.M., është i sistemuar në punët dhe detyrat e punës, punëtor teknik në SHFMU “4 Dëshmoret” në fshatin ..., komuna e Rahovecit, ndërsa në bazë të vërtetimit mbi ditët e prezencës në punë për paditësin Xh.M., të lëshuar nga drejtori i shkollës me datën 18.04.2021, është vërtetuar se i njëjti nga data 21.11.2019 e deri me datën 18.04.2021, ka gjithsej 273 ditë pune. Tutje gjykata ka arsyetuar se baza juridike e padisë ka rezultuar të jetë e bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, me anë të së cilës në mes tjerash punëdhënësi, sipas nenit 35 par.7 të Kontratës, obligohet që punëmarrësve tu sigurojë, shpenzimet e ushqimit, për këto arsye gjykata ka vendosur që të aprovojë kërkesëpadinë dhe të obligojë të paditurën që paditësve t’iu kompensojë shumat e përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Vendimin për kamatëvonesë, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 382 të LMD-së, ashtu që e njëjta do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata ka arsyetuar se ka vendosur konform dispozitave të nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së, pasi që sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar

faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë e ka vërtetuar gjendjen faktike, pasi që nuk është kontestuese së paditësit janë të punësuar tek e paditura, përkatësisht në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “4 Dëshmorët” në fshatin ..., Komuna e Rahovecit, ku vazhdojnë të jenë në të njëjtën pozitë të punës tek e paditura, ndërsa në bazë të vërtetimeve për ditët e prezencës në punë të datës 18.04.2021, të lëshuar nga SHFMU “4 Dëshmorët: në .., është vërtetuar se paditësit nga data 21.11.2019 e deri me 18.04.2021 kanë nga 273 ditë të pranisë në punë secili.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale, pasi që në bazë të nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe SBASHK-ku, dhe ka hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit datë 18.04.2017, është paraparë së *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy) euro, për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore...”*. Në mënyrë të njëjtë këtë çështje e ka rregulluar edhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.prot.105, e datës 22.01.2021, me hyrjen në fuqi të secilës është shfuqizuar Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë Nr.01B/2056, e datës 18.04.2017, ku në nenin 35 par. 7 ka përcaktuar së *“Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore...”*. Në rastin konkret, duke pasur parasysh se nga gjendja faktike e vërtetuar rezulton se paditësit kanë realizuar ditët e punës siç janë të theksua më lart, gjë që është vërtetuar sipas vërtetimeve të lëshuara nga SHFMU “4 Dëshmorët”, në ..., kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve si të bazuar, duke ia njohur shumat përkatëse të kompensimit për ushqimin gjatë ditëve të pranisë në punë secilit paditës veç e veç, andaj edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimit së e paditura nuk ka obligim ndaj paditësve pasi që e njëjta nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, Gjykata e Apelit, gjeti së ky pretendim është i pabazuar, pasi që në bazë të nenit 90 paragraf 1 të Ligjit NR.03/L-212 të Punës është paraparë së *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”*. Sipas paragrafit 2 të këtij neni përcaktohet së *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes”*. Ndërsa në bazë të nenit 2 par.1.2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila është nënshkruar nga MASHT-it dhe SBASHK, është paraparë së *“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat- DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj.) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”*. Ndërsa lidhur me pretendimin se e paditura nuk ka pranuar mjete financiare si organizatë buxhetore e nivelit lokal nga Ministria përkatëse, për çështjen e kompensimit të

shpenzimeve të ushqimit, Gjykata e Apelit vlerëson së koordinimi në mes të nivelit qendror dhe lokal në drejtim të alokimit të mjeteve për këtë kategori të pagesave që buron nga Kontrata Kolektive është çështje e brendshme e të paditurës me nivelin qendror dhe kjo assesi nuk mund të afekton në të drejtën e paditësve dhe detyrimin e të paditurës për kompensimin e ushqimit duke marrë për bazë faktin së e njëjta është punëdhënës i paditësve.

Lidhur me pretendimin ankimor së paditësit nuk i ka shterur mjetet e brendshme në procedurë administrative para se të dorëzohet padia në gjykatë, Gjykata e Apelit, vlerëson së e paditura ka pasur për obligim që paditësve t'ia paguaj kompensimin për ditët e pranisë në punë pa pasur nevojë që paditësit t'i drejtohet me kërkesë, dhe së në rastet kur kemi të bëjë me kërkesat në para, siç është rasti konkret, mos parashtrimi i kërkesës tek punëdhënësi nuk paraqet pengesë që i punësuari, në këtë rast paditësit për realizimin e të drejtës së tyre t'i drejtohet gjykatës me padi. Për me tepër, nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës rezulton se paditësit me kërkesa të veçanta i janë drejtuar të paditurës duke kërkuar kompensimin e shujtave-ushqimit gjatë ditëve të punës, dhe meqenëse e paditura nuk iu është përgjigjur kërkesave të paditësve të njëjtit kanë ushtruar padi në gjykatë.

Gjykata e Apelit, gjeti së vendimi lidhur me kamatën është marrë konform nenit 382 të LMD-së dhe Mendimit juridik për kamatën i Gjykatës Supreme të Kosovës, i datës 02.12.2020.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, Gjykata e Apelit e ka pranuar si të bazuar pretendimin e të paditurës, pasi që ka gjetur së gjykata e shkallës së parë i ka njohur shpenzimet paditësve edhe për parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë në shumë prej 208.00 euro, në kundërshtim me nenin 453 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore-LPK-së. Sipas kësaj dispozite është paraparë së *“Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t'i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendos gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat”*. Në rastin konkret paditësit kanë parashtruar padi për kompensimin e ushqimit për ditët e pranisë në punë dhe të njëjtit kanë pasur mundësi që precizimin e kërkesëpadisë ta bëjnë me rastin e dorëzimit të padisë në gjykatë pa pasur nevojë që përmes parashtrësës së veçantë të bëjnë precizimin e kërkesëpadisë. Për me tepër, duke qenë se gjykata e shkallës së parë ka mbajtur seancë, paditësit kanë pasur mundësi që precizimin e kërkesëpadisë ta bëjnë edhe në seancën përgatitore, andaj sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, paditësve nuk iu takojnë shpenzimet për parashtrësën për precizimin e kërkesëpadisë në shumë prej 208.00 euro, sepse siç është cekur me sipër precizimi është dashur të bëhet që me rastin e dorëzimit të padisë apo ka mundur të bëhet edhe në seancë gjyqësore. Prandaj, kjo gjykatë e ka ndryshuar aktgjykimin e atakuar në pikën III, dhe sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore duke u bazuar në nenit 449, 452 dhe 453 të LPK-së ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke i njohur paditësve shumën totale të shpenzimeve prej 499.40 euro, e cila shumë është llogaritur duke marrë për bazë shpenzimet për taksë gjyqësore për padi në shumë prej 21.00 euro, për përpilim të padisë në shumë prej 208.00 euro, për përfaqësim në një seancë në shumë prej 270.40 euro, sipas tarifës së Odës së Avokatëve për përpilimin e parashtrësave në procedurë civile dhe për përfaqësim në kontestet në vlerë mbi kontestin e vlerës së vogël e deri në 10,000.00 euro, për tre paditës.

Nga të lartcekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, paragrafi 1, pika d) dhe e), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.5076/2022, datë 30.04.2024

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Hysni Bardheci